



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport**

Mbledhja nr.56

Prishtinë, më 17.6.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sërgjan Popoviq, Bekim Haxhiu, Shpejtim Bulliqi dhe Mufera Shinik.

Munguan: Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyçi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Kujtim Shala, Ministër i MKRS-së, KDI-ja, mediat.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi, Salih Morina, nënkryetar i Komisionit.**

**Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të datës 14.6.2016;
3. Diskutim lidhur me gjendjen në infrastrukturën sportive;
4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-050 për Kinematografinë;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

### **2. Miratimi i procesverbalit të datës 14.6.2016;**

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 14.6.2016, u miratua pa vërejtje.

### **3. Diskutim lidhur me gjendjen në infrastrukturën sportive;**

Salih Morina, tha se në mbledhjen e fundit anëtarët e Komisionit miratuan kërkesën e deputetit Bekim Haxhiu, që në mbledhjen radhës të ftohet Ministri i MKRS-së dhe të diskutohet për gjendjen në infrastrukturën sportive. Ministrin e kemi sot prezent dhe e falënderojmë për ardhjen në Komision për t'na njoftuar për gjendjen në infrastrukturën sportive.

**Bekim Haxhiu**, tha se pranimi i Kosovës në UEFA dhe në FIFA, për të cilën kemi pritë kohë të gjatë, është sukses sepse tani të rinjtë tanë do të jenë të barabartë me të gjithë të rinjtë e botës dhe kjo barazi konsiston edhe për të luajtur në vendin e tyre edhe në fushat e tyre dhe këtu sigurisht kemi ngecje, të cilat nuk janë momentale por ndoshta janë ngecje të vazhdueshme, me anëtarësimin në UEFA dhe në FIFA, u vunë në pah shumë mungesa në infrastrukturë e edhe në infrastrukturën ligjore.

Klubet e Kosovës nuk arritën të shijojnë këtë kompeticion në Ligën e Evropës, mu për shkak të mosplotësimit të kriterëve financiarë, që është një kriter ligjor, dhe tjetrit, mungesës së infrastrukturës sportive. Qëllimi këtij takimi ka qenë me e pa mundësinë për arsye se javën e kaluar Kosovës edhe i është caktuar grupi për kualifikimet për Botëror dhe sigurisht gjithë sportdashësit dhe shikuesit dëshirojnë që Kosova ndeshjen e parë ta luaj në Kosovë dhe jo jashtë saj. Është një vërejtje që unë e kam parashikuar me vite, në mënyrë vjen një moment kur ne do të kemi të drejtë të luajmë, edhe ai moment që klubet dhe përfaqësuesja të luajnë jashtë Kosovës. Në buxhetin e vitit 2015, kam propozuar një amendament për të vazhduar investimet në stadiumin “Olimpik Adem Jashari” dhe kam kërkuar që të përshpejtohen investimet në Stadiumin e Prishtinës, se sa janë mundësitë që Kosova ndeshjen e parë zyrtare ta luaj në Kosovë dhe cilat janë këto mundësi që ne duhet ti përgatisim bashkë edhe nëse ka nevoja edhe me rishikimin e buxhetit, që ta arrijmë këtë nivel që e dëshirojnë gjithë sportistët, por edhe qytetarët e Kosovës.

Çështje tjetër është infrastruktura sportive në basketbollin e Kosovës, do ta ketë mundësinë e licencimit të këtyre objekteve sportive nga Federatat Ndërkombëtare e Basketbollit- FIBA dhe sa janë këto palestra të gatshme për certifikim ndërkombëtar për garat ndërkombëtare? Sa prej tyre pritet të certifikohen sipas standardeve ndërkombëtare dhe sa prej tyre duhet ne të investojmë apo t'i akomodojmë për gara ndërkombëtare, çoftë në hendboll, basketboll ose volejball? Për

këto arsye duhet rishikim buxhetor si ministri dhe duhet ta planifikoni që të kemi hapa konkretë në realizimin e projekteve në fjalë.

**Shpejtëm Bulliqi**, tha infrastruktura sportive nuk mund të bëhet brenda muajit edhe brenda javës, por është një proces që kërkon një periudhë pak më të gjatë kohore edhe për faktin se deri me sot nuk i është dhënë prioritet kësaj fushe. Është fat që u krijua mundësia që sportistët tanë të luajnë në arenat ndërkombëtare dhe është obligim i institucioneve të Kosovës që të krijojnë infrastrukturën e përshtatshme sportive dhe besoj që edhe Ministria e Kulturës është në vazhden e këtyre punëve edhe pse nuk është proces i lehtë.

Çështje tjetër është stadiumi në Mitrovicë, është procesi i investimeve dhe problemet me të cilat janë ballafaquar dhe problem tjetër është çështja e palestrave sportive, gjendja e tyre si dhe çështja e statuteve apo pronësisë së tyre.

Sërgjan Popoviq, kërkoi sqarim lidhur me investimet në komunat me shumicë serbe, sa është bërë dhe sa planifikohet të bëhen investime në këto komuna.

**Kujtim Shala**, tha se sa i përket fushave të futbollit, asnjë stadium nuk i plotëson kushtet dhe standardet e UEFA-së dhe FIFA-së. Pas anëtarësimit në UEFA, ne kemi formuar një komision që ka verifikuar gjendjen e dy stadioneve kryesore; stadiumit të Prishtinës dhe stadiumin Olimpik dhe janë kërkesa shtesë të cilat ka qene e pamundur fizikisht, por edhe financiarisht të plotësohen. Kemi krijuar një grup punues me përfaqësues të Ministrisë, të Federatës dhe të Komunës së Mitrovicës dhe nevojitet edhe dy muaj e gjysmë punë dhe investim rreth 1 milion e gjysmë euro. Për këtë kemi propozuar një buxhet shtesë nga fondet rezervë të Qeverisë e pritët që propozimi të dalë në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë.

Sa i përket klubeve, Shala theksoi se klubet nuk kanë mundur të garojnë për shkak të problemeve të pasqyrave financiare.

Çështja tjetër me kombëtaren është te infrastruktura. Këtë nuk mund ta plotësojmë në kohë por megjithatë kombëtarja e Kosovës nuk do të luajë në Kosovë ndeshjen e parë sepse Federata e Kosovës më 11 qershor ka marrë një shkresë nga UEFA-ja, ku është dhënë konfirmimi për caktimin e orarit të ndeshjeve, me njoftimin që ndeshja të mos luhet në Mitrovicë për shkak se ndërlihet me sigurinë politike..

Sa i takon stadiumit të Prishtinës, punët fillojnë këtë javë dhe do të zgjasim maksimalisht 14 muaj. Janë ndarë rreth 4 milion euro për renovim, duhet të bëhen edhe disa ndërhyrje te projekti sepse komisioni i UEFA-së ka dhënë disa sugjerime. Këtë vit kemi investuar edhe në stadiumin e Pejës, sikurse edhe në atë të Gjilanit dhe do të vazhdojmë edhe në këto tjerat.

Sa i përket investimeve në palestra, ka palestër që punimet kanë filluar qysh para 14 vjetëve, do të thotë ka pas një ritëm shumë të ngadalshëm. Këtë vit planifikohet të kryhet palestra e Shtimes, Kamenicës, Rahovecit dhe e Deçanit. Në pjesën e parë të vitit ardhshëm do të përfundojnë

punimet në Skenderaj. Edhe në Istog, po ashtu sivjet do të fillojmë palestrën, në Viti, në Dragash, në Podujevë, në Zhegër të Gjilanit, në Samadregjë të Vushtrrisë dhe në Zahaq të Pejës.

Përfaqësuesja e basketbollit do ti zhvillojë garat kualifikuese në tri palestra, në Prishtinë, në Pejë dhe në Gjakovë, por në Prishtinë nuk kemi mundur të bëjmë investime deri në këtë pjesë të vitit, për shkak të AKP-së tani është dhënë një leje që së paku të arrijmë ta bëjmë parketin.

Sa u takon komunave me shumice serbe, si në gjitha komunat, funksionojnë në bazë të kërkesave kryesisht të departamenteve komunale për poligone sportive, ndërkaq për katër komunat në veri, ne kemi nënshkruar memorandum me ato komuna dhe kemi investime afër 1 milion e gjysmë euro, por fondet u janë bartur komunave drejtpërdrejt, dhe ato i menaxhojnë dhe investojnë vetë drejtpërdrejt sipas specifikave që u janë caktuar në memorandum.

Sa i takon stadiumit nacional, në bashkëpunim me Federatën kemi përcaktuar si lokacion një zone në rrethin e Prishtinës, Bërnicinë, që është 4.4 kilometra nga qendra e qytetit, e ku janë 37 hektarë tokë në cilën kemi planifikuar të ndërtojmë stadiumin nacional.

Bekim Haxhiu, përveç stadiumit në Mitrovicë edhe në Prishtinë, pyeti se a janë mundësitë që të përshpejtohen investimet brenda këtij viti, që kompania të përshpejtojë dhe përfundojë rinovimet që të jemi koherentë dhe të shpejtë në përgatitjen e këtyre kushteve, sa i përket investimeve. Gjithashtu po befasohem me atë që Federata e Basketbollit ka përcaktua vetëm 3 palestra. Siç e dimë, palestra “Minatori” në Mitrovicë është rinovuar edhe janë investuar miliona euro në te dhe befasohem që ajo nuk mundet me qenë e gatshme për gara, pas gjitha këtyre investimeve. Çështja e tjetër, ne si Kuvend së bashku me ish- deputeten Vjollca Krasniqi, e kemi mbajtur një debat në Kuvendin e Kosovës për sportin, ku janë nxjerrë disa rekomandime që parashohin miratimin e ligjeve për sponsorizimet dhe Ligjin kundër huliganizmit, që janë ligje të rëndësishme.

Kujtim Shala, tha se rekomandimet e Kuvendit janë të përfshira në programin e Qeverisë, dhe lidhur me këtë kemi marrë një nismë tjetër që të rishikohet Ligji për Sportin, që të bëjmë një numër reformash. Sa i përket stadiumit Olimpik, ne duhet ta kemi gati për gjysmën e parë të shtatorit, kurse sa i takon palestrës “Minatori”, përkundër investimit shumë të madh të Qeverisë edhe të Komisionit Evropian, ajo palestër nuk i plotëson kushtet sepse numri i ulëseve është më i ulët dhe duhet të shtohen edhe rreth 450 ulëse, për te cilat ne jemi pajtuar që t’i bëjmë do të jenë teleskopike sepse nuk ka mundësi fizike, meqë hapësira e brendshme e saj, kur është rinovuar ka pësuar një ndryshim.

Mufera Shinik, kërkoi sqarim lidhur me prioritetet dhe investimet sportive në Komunën e Prizrenit. A janë bërë kërkesa prej departamentit për poligon të Prizrenit?

Kujtim Shala, sa i përket Prizrenit, tha se në takim me drejtuesit e Komunës së Prizrenit dhe të partive politike atje, s’kemi marre asnjë kërkesë. Gjendja në stadium nuk është e mirë,

ka pasur një investim para disa viteve dhe as ai nuk është cilësor, dhe me sa kam kuptuar ekziston një aktakuzë për atë investim. Prizreni si Komunë e madhe, ka edhe nevojat e mëdha si dhe komunat tjera .

#### 4. Të ndryshme.

Në mbledhjen e radhës, Komisioni pret një delegacion të Universitetit të Zagrebit, me ç' rast do të shtrojë një drekë pune.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

**Kryetari i Komisionit,**

**Nait Hasani**